



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 84-të të mbajtur më 30.03.2023 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-7436/1 të datës 29.07.2022, e dorëzuar kundër gjyqtareve të më shumë gjykatave **HIDHET POSHT**.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-7436/1 të datës 29.07.2022 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 29.07.2022, është dorëzuar denoncim kundër gjyqtareve të më shumë gjykatave dhe është formuar lënda me numër 12-7436/1 të datës 29.07.2022.

Parashtruesi thekson se më datë 24.12.2018 ka bërë padi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në ----- me anë të së cilës ka kërkuar mbrojtje nga ngacmimet dhe cenimi i së drejtës së saj të pronës nga i pandehuri -----
----- në paluajtshmërinë e tij në parcelën kadastrale të treguar, e cila thuhet se është fituar me marrëveshje dhuratë. Në vijim përshkruhet se si kryhet cenimi i së drejtës së saj pronësore dhe çfarë provash janë dorëzuar në gjykatë. Sipas pretendimeve nga kërkesa, gjyqtari ----- në seancën e mbajtur më datë 03.07.2019, ka ndërprerë procedurën pas padisë së parashtruesit për shkak se i padituri ----- ka ngritur padi kundër parashtruesit me kërkesë për përcaktimin e pronësisë. Në vendim thuhej se

procedura është pezulluar deri në përfundimin përfundimtar të procedurës pas padisë së personit -----, dhe lënda iu caktua të njëjtit gjyqtar i cili e ushtroi çështjen e tij dhe kërkesa e tij u miratua.

Parashtruesi thekson se kundër aktgjykimit ----- ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit -----, me ankesë kjo gjykatë ka vendosur aktgjykimin GZH nr. ----- datë 15.02.2021 e cila miraton ankesën e parashtruesit dhe ndryshon aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në ----- duke rrëzuar kërkesëpadinë e ----- . Parashtruesi thekson se i është drejtuar Gjykatës Themelore në ----- për vazhdimin e procedurës sipas kërkesës së saj, duke konsideruar se kanë pushuar arsyet e pushimit të saj. Parashtruesi u njoftua se e gjithë shkresa e lëndës i është dorëzuar Gjykatës Supreme për zgjidhje pas shqyrtimit të bërë nga ----- të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në ----- . Gjykata Supreme ka marr aktgjykim me te cilin miratohet revizioni, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës se apelit ----- dhe është vendosur refuzimi i ankesës se te pandehurit si i pabazuar vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë në ----- dhe urdhërohet i padituri që t'i paguajë shpenzimet paditëse në procedurë. Parashtruesi i kërkesës thekson se arsyet e deklaruara në aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë në kundërshtim me Ligjin për Pronën dhe të drejtat e tjera reale dhe konkluzioni i gjykatës është në kundërshtim me praktikën e mëparshme gjyqësore dhe qëndrimet dhe mendimet e publikuara parimore të Gjykatës Supreme, si dhe në kundërshtim me Ligjin për marrëdhëniet obligative. Për të gjitha këto, parashtruesi deklaroi se ka bërë ankim në seancën e përgjithshme të Gjykatës së Lartë dhe kërkesë në Këshillin Gjyqësor të RMV-së për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ----- në Gjykatën Themelore -----.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi ka të bëjë me pretendimet që i nënshtrohen veprimit kompetent të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili në pajtim me nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 180/2019), është kompetente për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe për të vepruar sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave.

Duke marrë parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh se parashtruesi deklaroi se një petition i është dorëzuar edhe Këshillit Gjyqësor, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka juridiksion për të vepruar në rastin në fjalë.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK – ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: B.K.SH.

Miratoi: Mr. SH. S, anē tar i KSHPK-sē

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Nēnkryetar,
Katica Nikolovska**

